

VENDIM
Nr.27, datë 12.1.2011

PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN E PËR MASËN E
PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL,
PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2011, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

II. Sektorët, që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

1. Prodhimi i frutave, ullinjve dhe rrushit;
2. Prodhimi i perimeve në serra;
3. Prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit;
4. Prodhimi i produkteve bio;
5. Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë;
6. Mbarështimi i njëthundrakëve në sektorin e lepurit.

III. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë për:

1. Mbjellje ullishtesh, përjashtuar zonat malore 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale;

2. Mbjellje arrash, bajamesh, lajthish dhe shgegësh, përjashtuar zonat malore, 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;

3. Mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkash, ftonjsh, përjashtuar zonat malore, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format intensive të kultivimit, dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për format tradicionale;

4. Agrume, kivi, banane dhe luleshtrydhe, përjashtuar zonat malore 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format intensive të kultivimit, dhe 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format tradicionale;

5. Mbjelljen e vreshtave, përjashtuar zonat malore, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara sipas masave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

6. Prodhimin e vajit të ullirit ekstra i virgjër, 100 (njëqind) lekë/litër për sasi të deri në 15 tonë/vit.

7. Ujitjen me pika në pemëtoreset, agrumishtet, ullishtet (intensive) ekzistuese dhe mbjelljet e reja, si dhe në vreshtat e serrat me ngrohje diellore e teknike, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

8. Prodhimin e produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara, 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë.

9. Blerjen e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

10. Pagesën me 10 (dhjetë) lekë/litër qumësht për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara të racave të pastra apo kryqëzimet e tyre, por jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruar në organet tatimore.

11. Pagesën me 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë, për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë njëthundrakë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) krerë.

12. Pagesën me 300 (treqind) lekë/krerë dele dhe dhi të matrikulluara për fermerët, përjashtuar ata në zonat malore, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë.

13. Pagesën me 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/fermë mbarështim lepur, për ferma me jo më pak se 100 (njëqind) krerë.

14. Pagesën me 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere blete.

15. Mbështetjen, përmes subvencionit, në masën 70 (shtatëdhjetë) % të normës së interesit, për 5 (pesë) vite radhazi, për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, që do të merren për:

a) veprimtaritë e ruajtjes, të përpunimit e të grumbullimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të kërpudhës;

b) mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin;

c) peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore.

16. Krijimin e fondit të garancisë për kreditimin e veprimtarisë bujqësore të agroindustrisë, si dhe të atyre të orientuara për eksport, për kreditë në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së principalit të kredisë. Garancia bëhet për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

IV. Masat mbështetëse me kritere lehtësuese për zonat malore e më pak të avantazuara të jenë për:

1. Mbjellje arrash, bajamesh, lajthish dhe shegësh, 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

2. Mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkash, ftonjsh, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për format intensive të kultivimit dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për format tradicionale.

3. Mbjelljen e vreshtave, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara sipas masave 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 1 (një) dynym.

4. Grumbullimin e gështenjës, 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave të shitura me faturë tatimore.

5. Pagesën me 300 (treqind) lekë/krerë dele dhe dhi të matrikulluara, për fermerët që mbarështojnë jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë.

V. Për informim mediatik të publikut lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të përdoren nga ky fond, për vitin 2011, 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

VI. Përcaktimi i kritereve për zonat malore e më pak të avantazuara bëhet në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

VII. Kriteret, procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

VIII. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha